



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2023, mbajtur më 12.08.2022, i cili filloi në orën 14:00.

Në dëgjimin publik morën pjesë: **Behxhet Reçica, Qerim Ademi, Sejdi Gashi, Gëzim Sveçla, Leorentë Alija, Arta Rafuna, Gëzim Zeqiri, Milazim Vitija, Granit Geci, Fisnik Osmani, Rrahman Ismajli, Naser Gashi, Qenan Osmani, Driton Rukiqi, Besart Peshku, Amir Simnica, Fehmi Kupina, Dasmor Durmishi, Jeta Rafuna, Donjeta Dregusha.**

Morën pjesë edhe: **Valbona Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, **Mimoza Sylejmani**, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, **Izet Sadiku**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, **Donat Lushaku**, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, **Plator Gërdovci**, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë..

Mblehjen e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**

Osman Bllaca i pershëndeti të pranishmit i cili tha se ky degjim publik ka të bëjë me hartimin e buxhetit për vitin 2023, i cili rrjedh prej kornizës afat mesme buxhetore 2023-2025, e të cilin e kemi hartuar në qershor të këtij viti.

Valbona Makolli, drejtoreshë e peshëndeti të pranishmit e cila më pas tha se materialin që ju kemi ofruar është vetëm propozim, kërkesat e juaja të gjitha do të shqyrtohen një nga një.

Buxheti për Komunën e Prishtinës do të jetë diku 105.495.981 euro, të ndara në 5 kategori dhe ne sot nga ju do të marrim parasysh kërkesat e juaja.

Qenan Osmani, banor nga lagja “Velania” tha se ne si lagje, sidomos pjesa urbane nuk kemi trafik urban të rregullt, mungon ndriçimi publik në disa rrugë, po ashtu ka qenë në projekt një unazë me lidh rrugën “1 tetori” me rrugën “Isa Kastrati”, por për shkak të shtrejttimeve që janë bërë ajo nuk është realizuar.

Rruga “1 tetori” që lidhet me rrugën “Dëshmorët e Marecit” dhe rrugën “Nazim Gafurri” një pjesë është rregulluar, një pjesë tjetër duhet rregulluar. Është më se e

Faqe 1 nga 5

nevojshme vendosja e një muri mbrojtës të çerdhja e fëmijëve, duhet rregulluar trotuaret si dhe kësaj lagje i mungon gjelbrimi.

Kërkojmë që rruga "Hamdi Gashi" të lirohet nga komunikacioni, kjo është shumë emergjente se është bërë rrugë lidhëse për Matiçanin dhe Bregun e Diellit.

Gani Sylja, banor i lagjes "Aleks Çaçi" te kolegji AAB, tha se në të dy anët e rrugës ka një mori biznesesh dhe shtëpi private, më herët e kemi njohur si zonë industriale tani ka edhe banim dhe se në at rrugë nuk ka as kanalizim e as ujësjellës.

Është gjendje alarmante sidomos për përdorimin e ujit nga pusët për shkak të gjendjes së gropave septike, kështu që besoj që realizimin e kërkesave tona do ta keni parasysh.

Naser Gashi, ngiti një shqetësim rreth disa pronave afër shkollës fillore "Iliria", në lagjen "Bregu i Diellit" i cili tha se me një vendim në viteve 80', një numri të konsiderueshëm të pronarve të shtëpive ju ka marrë prona, ku ata pronar kërkojnë që të shfuqizohet ai vendim dhe të bëhet legalizimi i pronave të tyre.

Po ashtu banorëve të fshatit Butovc, një pjesë e pronës ju ka kaluar në pjesën e zonës të mbrojtur, një pjesë në zonë të gjelbër, kështu që dikush tha që fshati Butovc u fshi prej hartës dhe mos na detyroni me shkuar në protesta, besoj që kjo qeveri do ti shqyrtoj kërkesat tona.

Valbona Makolli, lidhur me kërkesat dhe shetësimin e ngritur nga z. Gashi tha se kërkesat e juaja do të shkojnë në të gjitha drejtoritë.

Mimoza Sylejmani, drejtore tha se jemi në proces të Planit zhvillimor komunal, jemi duke u përgjigjur komenteve që i ka dhënë Ministria e Planifikimit Rural. Ka pasur edhe protesta, jemi në ngjarje dhe në fund të gushtit dhe në fillim të shtatorit do të jemi në të gjitha fshatrat e Prishtinës, pra do të jemi edhe në fshatin Butovc për diskutime.

Behxhet Reçica, përfaqësues i fshatit Vranidoll tha se ne kemi nevojë për rindërtimin e dy rrugëve të fshatit, kanalizimi në dy lagjet e fshatit, ujësjellësi është mjerim, është më se e domosdoshme thurja e varrezave dhe rregullimi i tyre si dhe ende nuk është përfunduar emërimi i rrugëve.

Mungon ndriçimi publik, shtyllat elektrike ende janë prej druri, pra kërkojmë që me na u rregulluar si të gjithë të tjerëve. Ka që 8 vjet kan filluar punimet për ndërtimin e shkollës tani ato veq janë ndërprerë, ku nxënësit janë të detyruar të shkojnë me autobus në Tenezhdoll.

Donjeta Dragusha, anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në cilësinë e banores së fshatit Prugovc tha se problemi kryesor që e kemi tani për tani për fshatrat Prugovc, Barilevë, Dranovc, Besi, Vranidoll dhe pothuajse gjitha fshatërat veriore në Komunën e Prishtinës, është transporti publik. Aktualisht në Barilevë, Drenovc, dhe Prugovc, funksionon një operator privat i cila ka linjë të autobusit për në Prishtinë çdo dy orë.

Probleme kemi edhe me ndriçimin publik ku disa rrugë nuk janë të pajisura me shtylla elektrike fare, problem tjetër është kanalizimi, ku prej fshatit Bardhosh derdhet në disa parcela në fshatin Prugovc, ku dhe shkaktojnë shumë probleme.

Është më se i nevojshme edhe rregullimi i shtrati të lumit Llap është urgjente, sepse çdo vit shtëpitë afër vërrshohen nga lumi.

Rregullimi i varrezave është urgjente, po ashtu në këtë lokalitet nuk ka çerdhe, nuk ka shtëpi të kulturës.

Qerim Ademi, tha se një plan zhvillimor urbanistik është bërë në 2012, deri në vitin 2022, atëherë 3 bashkësi lokale, ajo e Llukarit, Bardhoshit dhe e Besisë e kemi pasur një ide për një projekt për shtrirjen e ujësjellësit në verilindje të Prishtinës për fshatrat e kësaj zone. Po ashtu edhe në fshatin Koliq mungon uji, si dhe është e domosdoshme të rregullohet edhe rrjeti i energjisë elektrike.

Nehat Gashi, qytetarë tha se në lagjen tonë nuk është ndërtuar asnjë çerdhe, prandaj shpresojmë shumë nga z. Përparim Rama ta realizon një çerdhe për lagjen tonë. Lidhur me këtë propozoi që ish- rruga Proleteri, aty ka tokë komunale dhe ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e një çerdheje.

Mimoza Sylejmani, drejtore tha se në Kuvendin e Komunës janë votuar tri lokacione për ndërtimin e çerdheve, prandaj një çerdhe do të jetë afër shkollës së Gjelbër dhe një çerdhe mbrapa shkollës "Xhavit Ahmeti".

Gëzim Sveçla, anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, tha se programi me të cilin i ka fituar zgjedhjet kryetari aktual, ka diçka të planifikuar për vitin e ardhshëm, pyetja ime është çka është me premtimet tjera, pse nuk janë të inkorporuara në planin buxhetor, ku janë shkollat, disa prej tyre që janë me partneritet publiko-privat. A janë siguruar fonde, a ka me arrite këtë mandat me ndërtua ndonjë shkollë të re në Komunën e Prishtinës.

Mimoza Sylejmani, drejtore tha se për 3 shkolla është dhënë drita e gjelbër, nevojitet vetëm edhe një leje prej Ministrisë së Financave edhe ajo është në përfundim e sipër. **Jeta Rafuna**, anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës parashtrroi dy kërkesa në emër të banorëve të lagjes "Taslixhe". Rruga e cila ka qenë e paraparë të shtrohet në kubza, në "Taslixhen 2", ajo nuk është shtruar dhe gjendja në atë rrugë është alarmante.

Një kërkesë tjetër është, rruga 'Nazim Gafurri' deri te 'Avalla', ka problem të madh për transport publik, rrugët janë të ngushta nuk i zënë autobusët dhe do të ishte mirë Komuna të angazhon ndonjë minibus për transportin e fëmijëve për në shkollë.

Driton Rukiqi, anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, tha se në rrugë "Dëshmorët e Marecit" në lagjen "Velania" janë sanuar të gjitha problemet në pjesën e asfaltimit të rrugës. Në mes të rrugës "Dëshmorët e Marecit" dhe Qendrës së strehimit "Sos Kinder", është një parcelë e Komunës, ku kemi menduar dhe pretendojmë të ndërtohet ndonjë qendër rekreative për të rinj, si për ndonjë këndë të lojërave, vendosjen e ndonjë tavoline për ping - pong, etj.

Një problem që veçohet është edhe bllokimi i trotuarve nga automjetet, si dhe po ashtu të banesat e bardha problem është mungesa e ngrohja dhe e ashensorëve.

Amir Simnica, anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, njëherit banor i lagjes së Muhaxhirëve, i cili tha se disa kërkesa i kam adresuar dje këtu në mbledhje. Në rrugën "Rrustem Statovcii gjithë trotuari është i bllokuar prej automjeteve, si dhe rruga "Dubrovniku", komplet hapësira shfrytëzohet nga klientët e marketit që është hapur aty.

Feim Osmani tha se Korniza buxhetore është shumë e mangët, nuk janë shumë kërkesa në projektin e buxhetit, po duhet me i përsërit kërkesat vazhdimisht, si ato për trajtimin e

shtratit të lumit Llap, ndërtimi i një shkolle në Besi, ujësjellësi dhe kanalizimi për fshatin Sharban dhe Rimanishtë. Trajtimi dhe mirëmbajtja e rrugicave, trajtimi i disa rrugëve të kategorisë së dytë, rrjeti për ndriçim publik. Shuma e mjeteve prej 700 mijë euro më shqetëson që figuron ende për shkollën e Vranidollit.

Valbona Makolli, drejtore tha se pa i dëgjuar të gjitha kërkesat nuk mundemi me e bërë asnjë projekt, dhe se Qarkoren e dytë ende nuk e kemi pranuar nga Ministria e Financave, jemi duke punuar me Qarkoren e parë.

Mirsad Vitia, anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në cilësinë e banorit të lagjes Hajvalia, tha se në Drejtorinë e Kulturës mungon projekti për ndërtimin e shtëpisë së kulturës, projekt i premtuar në zgjedhjet lokale.

Do të ishte mirë që rikonstruktimi i rrugës “Nekibe Kelmendi”, të parashihet në buxhetin e vitit 2023. Po ashtu ndërtimi i rrugës Hajvali-Veternik, duke u lidhur me pjesën e anamoravës nuk figuron në buxhet, ndërtimi nëntokësor në lagjen “Dardania” si projekt është e paraparë, por nuk ka mjete të ndara. Gjithashtu do të ishte shumë e rëndësishme ndërtimi i rrugës prapa Swiss apartament, apo siç njihet banesat e pacollëve në Hajvali, është një rrugë aty që ka pasur probleme pronësore, është vetëm me zhavorr nuk është ndërtuar.

Valbona Makolli, drejtore tha se rruga “Nekibe Kelmendi” veç ka dal ne tenderim, por nuk mjaftojnë mjetet dhe për atë arsye ka mbetur për vitin 2023.

Dasmor Durmishi, anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës tha se nuk po e shoh si të arsyeshme që rruga “Nekibe Kelmendi” të shtyhet për ndërtim vitin 2024.

Triera Kasumi, anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, kërkoi të dijë se a do të realizohet projekti për ndërtimin e thertores, pasi që ky projekt është në interes të gjithë qytetarëve. Sa i përket mirëmbajtjes zonale në Komunën e Prishtinës, si do të shpenzohen ato mjete, çka konkretisht do të investohet, meqë është një buxhet i konsiderueshëm në shumën prej 5.5 milion euro.

Valbona Makolli, drejtore tha se për thertoren veç është përcaktuar lokacioni dhe fizibiliteti për këtë vend dhe është në proces e sipër.

Sa i përket mirëmbajtjes zonale, është ndarja në zona të qytetit, do të ketë ndarje një, dy, tre zona dhe kur të ketë nevoj për intervenime të shpejta të mos ketë nevojë për tenderim.

Plator Gërdovci, drejtor tha se shuma e mjeteve prej 400.000 euro për projektin e thertores është e pa mundur me u realizuar ky projekt.

Caktimi i lokacionit për këtë projekt është ideal, përball tregut të kafshëve, hapësirë e mjaftueshme që asaj thertore me ja bashkëngjit edhe tregun e kafshëve që të kryhen gjitha funksionet në një vend.

Rashit Gashi, anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës tha se fshatrat në zonën e Gollakut po anashkalohen me këtë buxhet, përveç thertoren e cila vjen nga Drejtoria e Bujqësie, gjitha projektet tjera janë të kaluarës.

Po të krahasohet Prevalla me Butovcin, mund të konstatojmë se sa investim është bërë atje, ndërsa Butovci nuk është zhvilluar as si zonë për turizëm, e as për banim të atyre njerëzve që prej viteve janë shpërngulur prej aty. Fshati Mramor nuk ka ujë të pijes, tash veç në muajin gusht e ende nuk ka filluar projekti i ujësjellësit për fshatrat e Gollakut,

konkretisht për fshatin Mramor. Kanalizimi, ujësjellësi dhe një çerdhe janë minimalet për këto dy vite të qeverisjes Rama që duhet bër për ne.

Ermal Osmani, anëtar i Kuvendit në Komunën e Prishtinës tha se lagja “Bregu i Diellit” ka nevojë për shumë projekte, duke filluar nga parqet dhe hapësirat gjelbëruese. Në propozim buxhetin ka mjete për ndërtimin e disa fontanave të reja, sepse kjo lagje ka shumë lokacione që do ta zbukuronin shumë pjesën tonë. Sa i përket projekteve të mëdha, dy parkingje nëntokësore i ka Bregu i diellit më se të nevojshme, lokacioni te qendra tregtare dhe te xhambazët, por është më se e domosdoshme të kemi edhe hapësira tjera për parkingje. Po ashtu kërkoi të dijë se a është caktuar lokacioni për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve dhe për këtë çështje ju bëjë me dije se në fund të rrugës “Enver Maloku” te “Max 24”, është një pjesë shumë e mirë, që mund te ketë qasje në të gjitha rrugët.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Pjesëmarrja në diskutime publikë lidhur me Planifikimin e buxhetit të vitit 2023,

më 12.08.2022.

	Emri dhe Mbiemri	Gjinia M/F	E-mail	Nëshkrimi
1	Behxhet Beçiraj			
2	Gezim Ademi			
3	Sevdai Gashi			
4	Gëzim Suela			
5	Adriente Alija			
6	Arta Rafuna			
7	Gezim Zejri			
8	Mirza Vitiq			
9	Samir Geci			
10	FISNIK OSMANI			
11	REHMAN ISMAILI			
12	Nesir Garib			
13	Renon Osmani			
14	DELTON RUKIAI			
15	Besmir Besku			
16	Admir Shkurtaj			
17	Sehmi Myrtinga			

18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					